



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 991/11 Prot

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr. 176, Datë 30.12.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE GJIROKASTËR “MBI
PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË RAJONALE
TATIMORE GJIROKASTËR, ME KRITERET DHE KËRKESAT E KUADRIT
RREGULLATOR NË FUQI”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeadituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi” për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave për periudhën 2014 dhe 2015 rezultoi se, të ardhurat tatimore në total për vitin 2014, janë realizuar në masën 97 % ose nga 2,459,000 mijë lekë që ishte plani, janë arkëtuar 2,397,220 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute në shumën 61,780 mijë lekë, nga të cilat 17,952 mijë lekë nga të ardhurat tatimore dhe 43,828 mijë lekë nga kontributet e sigurimeve shoqërore. Për vitin 2015, të ardhurat tatimore në total janë realizuar në masën 93.6% ose nga 2,167,000 mijë lekë që ishte plani, u arkëtuan 2,028,770 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute në shumën 138,230 mijë lekë, nga të cilat 84,805 mijë lekë nga të ardhurat tatimore dhe 53,425 mijë lekë nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Për të dy vitet e audituara, DRT Gjirokastër rezulton me mosrealizim të planit të të ardhurave, situatë për të cilën nuk është bërë analizë e detajuar e faktorëve të mosrealizimit të planit, dhe nuk është vepruar për të marrë masat e nevojshme për realizimin e të ardhurave buxhetore. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga DRT Gjirokastër të bëhet analizë e detajuar e aktivitetit operacional në drejtim të realizimit të ardhurave tatimore, për të identifikuar risqet e lidhura me mosrealizimin e tyre dhe për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e treguesve fiskalë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, u konstatua se për vitin 2014 detyrimet e pambledhura në fund të vitit janë në vlerën 391,422 mijë lekë, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur në total për shumën 22,433 mijë lekë ose në masën 5.7%. Në totalin e borxhit për vitin 2014 detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 115,381 mijë lekë ose 29.5% e të gjithë borxhit.

Për vitin 2015 detyrimet e pambledhura në fund të vitit janë në vlerën 390,939 mijë lekë, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë ulur për shumën 483 mijë lekë ose në masën 0.2%. Në totalin e borxhit për vitin 2015 detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 112,759 mijë lekë ose 28.8% e të gjithë borxhit. Për vitin 2014, nga marrja e masave shtrënguese në shumën 406,993 mijë lekë janë arkëtuar 71,129 mijë lekë ose 17.5% dhe për vitin 2015, nga marrja e masave shtrënguese në shumën 262,672 mijë lekë, janë arkëtuar 50,975 mijë lekë ose 19.4%. Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet i ulët në shumën e arkëtuar. Nga auditimi u konstatua se për debitorët nuk janë vendosur masat shtrënguese “Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë”, “Njoftim Transferim Detyrimi Palës së Tretë”, “Njoftim për Transferimin e Detyrimit të Ortakut, Aksionerit, Administratorit”, “Urdhër Bllokimi në Doganë”, veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, nenet 94-98 dhe udhëzimit në zbatim të tij.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Mbledhjes së Borxhit, sipas debitorëve të evidentuar në regjistrin e borxhit, të vazhdojë marrjen e masave shtrënguese, për “Urdhër Sekuestrimi

të Pasurisë”, “Njoftim Transferim Detyrimi Palës së Tretë”, “Njoftim për Transferimin e Detyrimit të Ortakut, Aksionerit, Administratorit”, “Urdhër Bllokimi në Doganë”.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit u konstatuan se nga inspektorët nuk është bërë shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare për vitet 2013 dhe 2014, nuk janë analizuar dhe evidentuar subjektet me humbje tatimore, vitet e njëpasnjëshme të bilanceve me kapital negativ, dhe detyra të tjera të parashikuara në udhëzimet përkatëse rregullatore. Në këtë mënyrë nuk është realizuar një përzgjedhje e subjekteve për kontroll, si dhe inicimit të procedurave për kalimin në faliment. Këto mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar si dhe udhëzuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 36-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Vlerësimit në DRT Gjirokastër të shqyrtojë pasqyrat financiare të subjekteve, si një proces sistematik i përvitshëm, duke u fokusuar gjithashtu në vitet 2013 dhe 2014. Kjo analizë të përfshijë problematikat në lidhje me analizën e shpenzimeve, pasqyrën “cash flow”, llogarinë ortak, humbjen ushtrimore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit të evidentojë, shqyrtojë dhe dërgoj për kontroll subjektet që kanë deklaruar një nivel humbje të madhe për vitin ushtrimor, duke kërkuar një mbulim mbi 50% të humbjeve të deklaruara.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për të gjitha rastet e përcaktuara në kërkesat e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat në RSH", i ndryshuar, neni 104 "Fillimi i procedurave të falimentimit".

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për rimbursim, të realizuara nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, u konstatua se tatimpaguesi [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR], ka përfituar rimbursimin e TVSH-së për blerjet e makinerive dhe pajisjeve nga importi, transaksion i vitit 2007 në shumën 43,970,137 lekë. Në raportin e kontrollit tatimor janë pasqyruar pagesat e TVSh-së, por nuk janë bashkëlidhur si dokumentacion për të vërtetuar pagesën e kryer. Në sistemin Oraclen, për këtë periudhë tatimore mungojnë të dhënat për importet dhe pagesën e TVSH-së, si burim informacioni për pagesën e kryer në doganë. Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, neni 16, lejonte skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineri dhe pajisje të importuara, për të cilën nga inspektori nuk është shprehur nëse tatimpaguesi ka përfituar ose jo nga kjo skemë. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 25-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit në DRT Gjirokastrë, për tatimpaguesin [REDAKTUAR], ti drejtohet zyrtarisht Degës Doganore ku është kryer importi për makineri dhe pajisje, për të verifikuar pagesën e TVSH-së në doganë për çdo deklaratë doganore importi, për të cilën është përfituar rimbursimi i TVSH-së në shumën 43,970,137 lekë.

Deri më 31.03.2017

5. Gjetje nga auditimi: Njoftim vlerësimet e rezultuara nga kontrolli tatimor për subjektin [REDAKTUAR], me Nipt [REDAKTUAR] dhe subjektin [REDAKTUAR] me Nipt [REDAKTUAR], nuk janë reflektuar në sistemin tatimor C@TS. Tatimpaguesit nuk rezultojnë me detyrim për zbulimin e konstatuara nga kontrolli. Ky mosveprim nga ana e inspektorëve të vlerësimit, të dosjeve përkatëse, bie në kundërshtim me parashikimet e Manualit për procedurat e përpunimit të deklaratave tatimore, vlerësimit dhe rimbursimit të detyrimeve tatimore pika nr. 2.10.2. dhe në mospërputhje me nenin 74 pika 2 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Vlerësimit në DRT Gjirokastrë, të merren masa të menjëhershme, për të reflektuar detyrimet e rezultuara nga njoftim vlerësimi i kontrollit tatimor për subjektet [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional rezultoi se për periudhën 2014 janë realizuar 147 kontrole me zbulim në total në shumën 106,370 mijë lekë, me forcë zbuluese për kontroll në shumën 724 mijë lekë dhe forcë zbuluese për inspektor në shumën 11,819 mijë lekë. Për periudhën 2015 janë realizuar 55 kontrole me zbulim në total në shumën 65,965 mijë lekë, me forcë zbuluese për kontroll në shumën 1,199 mijë lekë dhe forca zbuluese për inspektor në shumën 9,424 mijë lekë. Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 kemi ulje me 92 raste të kontroleve të realizuara, ndërkohë që treguesi i zbulueshmërisë ka rënie me 40,405 mijë lekë ose është 38% më i ulët se viti paraardhës. Të dhënat reflektojnë rënie të zbulueshmërisë për inspektor në shumën 2,395 mijë lekë.

Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit u konstatuan se:

Në përshkrimet e raporteve të kontrollit mungonte një analizë e detajuar e Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve, veprime në mospërputhje me kërkesat e programit të kontrollit të parashikuar, metodologjisë së manualit të kontrollit tatimor, duke mos reflektuar përputhjen me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në analizën e importeve në praktikat e kontrollit mungojnë të dhëna për referencat doganore, për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruara në FDP me shpenzimet në bilanc. Ky mos raportim krijon pamundësinë e evidentimit të përputhshmërisë së deklaratimeve tatimore me legjislacionin, duke lënë vend për keq

deklarim të shumës së shpenzimeve, fshehje të vlerës së shtuar dhe eventualisht edhe të detyrimeve tatimore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor të merret në analizë performanca e ulët e kontrolleve të realizuar dhe fokusimi në kontrole mbi bazë risku në të ardhmen, me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturave të kësaj drejtorie në luftën ndaj evazionit fiskal.

6.2. Rekomandimi Në vijimësi në çdo praktikë të realizuar nga Drejtoria e Kontrollit të bëhet një analizë e hollësishtme dhe e dokumentuar të shpenzimeve të subjektit, duke evidentuar tipin e faturimit, përfshirjen apo jo në Librin e Blerjeve dhe Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së, për të rakorduar blerjet e deklarimit në FDP me deklarimin në bilanc, si të shpenzimeve ashtu edhe të të ardhurave. Kjo analizë duhet të jetë pjesë e inventarit të dosjes dhe e evidentuar më vete në raportin e kontrollit.

6.3. Rekomandimi Në vijimësi të pasqyrohet në programin e kontrollit si një kërkesë e veçantë për tu analizuar referencat doganore. Rezultatet e kësaj analize të përfshihen në raportin e kontrollit të subjektit duke pasqyruar veçmas vlerën e faturës së origjinës dhe vlerën e referencës doganore të aplikuar.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raporteve të përpiluara nga Drejtoria e Kontrollit Operacional, u konstatua se në analizën e zërave të bilancit me efekt në tatimin mbi fitimin nuk arsyetohet dhe nuk sqarohen kronologjia në vite e llogarisë “Ortak” si dhe burimi i fondeve të tyre. Mungesa e kësaj analize krijon pamundësi për të evidentuar formimin e vlerave pasurore në pronësi të subjektit që po kontrollohet. Mungesa e kësaj analize është në mos përputhje me metodologjinë e parashikuar në manualin e kontrollit si dhe në kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi. Në vijimësi në çdo praktikë të realizuar nga Drejtoria e Kontrollit të bëhet një analizë e detajuar e llogarisë “Ortak” si dhe burimi i fondeve. Rezultatet e kësaj analize të pasqyrohen veçmas në raportin e kontrollit të subjektit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Verifikimit në Terren, u konstatua se në vitin 2014 janë plotësuar 2,777 raste Akt-Konstatimesh dhe nga protokollin kanë kaluar 349 raste Akt-Konstatime për tu arkivuar ose për të kaluar në destinacione të tjera për procedura të mëtejshme. Për 2,428 raste Akt-Konstatimesh të plotësuara nga inspektorët e terrenit, nuk ka evidenca apo informacion për gjendjen fizike të kopjes së parë të Akt-Konstatimeve. Kjo mungesë bie në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, nenin 21 të “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreut IV pika 1 e Manualit të Verifikimit në Terren, duke lënë mundësi për tjetërsime dhe keqpërdorime të këtyre dokumenteve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë dhe Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar gjendjen fizike dhe destinacionin e kopjes së parë, të 2,428 Akt Konstatimeve të plotësuara për vitin 2014, të evidentohen personat përgjegjës dhe të informohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve..

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i rregullshmërisë së dokumentacionit të përpiluar nga Sektorit të Verifikimit në Terren dhe konkretisht në procesverbalet me nr. 0670006, datë 16.12.2015; nr. 0498723, datë 25.11.2015; nr. 0498134, datë 20.11.2015 dhe nr. 0498750 datë 01.12.2015, u konstatua se është tjetërsuar shkrimi me efekt fshehjen e emrit të punonjësve të gjetur në vendin e punës e të pa raportuar, në kundërshtim me parashikimet e manualit të kontrollit tatimor, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” në zbatim të tij, paragrafi 36 “Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë të verifikojë arsyet e tjetërsimeve dhe korrigjimeve të bëra në këto dokumente. Për këtë të ngrihet grupi i punës së përbërë nga inspektorë të DRT Gjirokastrë dhe Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet eprorë dhe paralele, me veprimet dhe mos veprimet e saj, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, i ka sjellë buxhetit të shtetit një nivel mungese të ardhurash në masën **102,702,487 lekë**, për të cilën kanë përgjegjësi personat konkretë të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Operacional nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, me ligjet specifike tatimore që përcaktojnë detyrimin tatimor si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre, duke sjellë vetëm nga kontrolli tatimor për periudhën 2014-2015, një shmangie në shumën **56,275,850 lekë për 34 subjekte**.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 3.1.1 bashkëngjitur)

1.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 34 subjekte ***në shumën 56,275,850 lekë.***

Deri më 30.06.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” germa “ë” dhe neni 35 “Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi”, Udhëzimi nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 2.3.6 dhe Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 117 në lidhje me mbledhjen e tatimit në burim mbi të ardhurat nga qeraja për llogari të organeve tatimore, për 80 subjekte, me një efekt ***në shumën 480,274 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 21-25 Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.1 bashkëngjitur)

2.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 80 subjekte ***në shumën 480,274 lekë.***

Deri më 31.03.2017

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33/1, pika 3 dhe ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, për penalitetin e pa vendosur subjekteve, të cilët kanë arkëtuar tatim dividendit jashtë afatit ligjor për shpërndarjen e fitimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2013, për 6 subjekte me një efekt ***në shumën 1,674,433 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 21-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në Tabelën nr. 2.2.2 pjesë RPA)

3.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 6 subjekte ***në shumën 1,674,433 lekë.***

Deri më 31.03.2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” nenit 117, për të mbledhur dhe penalizuar subjektet që nuk kanë paguar për llogari të administratës tatimore, tatimin mbi dividendin e pagueshëm për shpërndarjen e fitimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2013, për 11 subjekte me një efekt ***në shumën 1,326,930 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 21-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Tabelën nr. 2.2.3 pjesë RPA)

4.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 11 subjekte me një efekt ***në shumën 1,326,930 lekë.***

Deri më 31.03.2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1 dhe 33/2, në lidhje me mos dorëzimin brenda afatit ligjor, të vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit të rezultatit financiare të vitit ushtrimor 2013, për 19 subjekte me një efekt ***në shumën 3,880,000 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 21-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimi si dhe në Tabelës nr. 2.2.1 pjesë RPA,)

5.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 19 subjekte me një efekt ***në shumën 3,880,000 lekë.***

Deri më 31.03.2017

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenit 19 dhe nenit 29, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, nenit 126 “*Mosdhënia e informacionit*” për mosdhënie informacioni për pranimin e pasqyrave financiare të vitit 2013 dhe pasqyrave financiare të vitit 2014, mungesa e të cilave nuk është kërkuar nga inspektorët, për 568 raste, me një efekt ***në shumën 28,400,000 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në Aneksin nr. 2.1 bashkëngjitur)

6.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 568 raste me një efekt ***në shumën 28,400,000 lekë.***

Deri më 30.06.2017

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 122 pika 1, germa a, b në lidhje me vendosjen e penaltetit për mosinstalim të pajisjes fiskale dhe për mos lëshimin e kuponit tatimor, për 90 raste (subjekte) me një efekt ***në shumën 10,665,000 lekë.***

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 90 raste (subjekte) me një efekt ***në shumën 10,665,000 lekë.***

Deri më 31.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58, germa (ç) “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil si më poshtë:

1. Z. B. L., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor

- Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Znj. V. R., me detyrë Përgjegjëse e Drejtorisë së Vlerësimit

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Neni 58, germa (ç) “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:

3. Znj. E. B., Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

4. Znj. H. M., Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

5. Z. R. K., ish-Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor, aktualisht Specialist Borxhi

6. Znj. N. A., Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.

- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 19-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Z. I. P., Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

8. Z. F. K., Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

9. Z. B. A., Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

10. Z. V. V., Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11. Znj. S. T., Drejtoreshë në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor (e komanduar)

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 29.1 ku citohet: “*Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjokat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit*”

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12. Z. E. M., Përgjegjës i Sektorit të mbledhjes së Borxhit

-Për mosdhënien e masave shtrënguese sipas ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, nenet 94-98 dhe udhëzimit në zbatim të tij.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 118-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Mbështetur në kreun XIV kapitullin C “**Zgjidhja e Menjëhershme e Kontratës**”, Neni 153 të ligjit nr. 9125, datë 29.7.2003 “**Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë**”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “**Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë**” të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 153 të ligjit nr. 7961, **për punonjësin si më poshtë:**

13. Znj. E. Ç., Punonjëse shërbimi

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit në Terren.

- Në katër raste është konstatuar se: Punonjësja **znj. E. Ç.** ka bërë korrigjime dhe **fshirje** në Akt-Konstatimet origjinale (kopja 1), duke tjetërsuar vërtetësinë e dokumenteve zyrtare.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2-Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësit e larguar nga sistemi tatimor, sipas Neni 58 germa “ç”, janë në nivelin e masës “Largim nga shërbimi civil”, për të cilët, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësit e mëposhtëm:

- 1. z. A. M.** ish-Përgjegjës i Sektorit të Verifikimit në Terren
- 2. z. S. M.** ish- Inspektor i Verifikimit në Terren
- 3. z. F. F.** ish- Inspektor i Verifikimit në Terren
- 4. znj. A. G. (K.)** ish- Inspektore e Verifikimit në Terren
- 5. z. G. K.** ish- Inspektor i Verifikimit në Terren

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit në Terren.

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësit e larguar nga sistemi tatimor, sipas Neni 58 germa “c”, janë në nivelin e masës “pezullim nga drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për të cilët, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësit e mëposhtëm:

- 6. z. K. K.** ish- Drejtor i Drejtorisë Rajonale
- 7. z. P. M.** ish- Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 8. z. M. G.** ish- Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 9. z. S. K.** ish- Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor
- 10. z. A. A.** ish- Inspektor i Verifikimit në Terren
- 11. z. V. R.** ish- Inspektor i Verifikimit në Terren
- 12. z. S. T.** ish- Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

- Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.

- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

3. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësi, znj. E. P., z. T. Xh., z. E. Xh., z. A. I., znj. M. K., znj. A. V., znj. J. K., z. E. M., znj. A. K., znj. V. B., z. I. B. është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore, pasi mospërbushja e detyrave prej tyre nuk është në nivelin e përgjegjësive për fillimin e ecuresë disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R